



... policy impact since 2004

Center for
Research and
Policy
Making

Transparenca Institucionale: Liria e informimit

Analiza Nr: 35

Shkup, Maqedoni
Dhjetor, 2015

Kjo analizë është pjesë e projektit:



E financuar nga
Bashkimi European

E bashkë-financuar nga
Ambasada Britanike në Shkup

Botuar nga:

Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave

Cico Popovic 6-2/9, 1000, Shkup

Tel/fax: +389 3109932

www.crpm.org.mk | crpm@crpm.org.mk

Autore:

M-r. Qëndresa Sulejmani

Redaktore:

D-r. Marija Risteska

Përgaditje teknike dhe dizajn:

Produkcija Perspektiva

Shtypur nga:

MagnaSken

Dhjetor 2015

Shkup Maqedoni

Komentet dhe vërejtjet e juaja vlerësohen: crpm@crpm.org.mk

Ambasada britanike në Shkup ka bashkë-financuar përgaditjen e këtij botimi në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi evropian „Avokim për qeveri të hapur: përcaktim i agjendës nga shoqëria civile dhe monitorim i plan veprimeve të vendeve”. Përmbatja e këtij publikimi nuk e pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin apo mendimet e Ambasadës britanike në Shkup dhe Bashkimit evropian.

Përmbajtja

SHKURTESA.....	4
RRETH SERISË SË ANALIZAVE TË SHKURTËRA.....	4
HYRJE	5
1. QASJE E INFORMACIONEVE PUBLIKE.....	6
1.1. Qasje e lirë e informacioneve (QLI)	6
1.2. Faqet e internetit si platforma kryesore për transparencë	8
1.2.1. Të dhëna të lexueshme nga makina	8
1.2.2. Çfarë informacione publikojnë institucionet?.....	10
2. PLAN VEPRIMI PËR 2014-2016 DHE TRANSPARENCA	14
2.1. Liria e informimit.....	14
2.2. Të dhëna të hapura	17
PËRFUNDIM	19
REKOMANDIME	21

SHKURTESA

Komisioni për QLI	Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik
CRPM	Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave
OSHC	Organizata të shoqërisë civile
ESE	Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave
QLI	Qasje e lire e informacioneve
Ligji për QLI	Ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik
MShIA	Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës
PQH	Partneritet për qeverisje të hapur

RRETH SERISË SË ANALIZAVE TË SHKURTËRA

Kjo analizë e shkurtër është pjesë e serisë së tre shkrimeve mbi qeverisjen e mirë të cilat kanë për qëllim të ofrojnë një analizë të detajuar dhe të vazhdueshme të implementimit të parimeve kyçe të qeverisjes së mirë në vend, siç janë (1) transparencja, (2) llogaridhënia dhe (3) pjesëmarrja qytetare – temat kryesore të tre analizave të shkurtëra. Ky trend i analizave të shkurtëra po publikohet për herë të dytë nga Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave (CRPM) në kornizat e projektit rajonal „Avokim për qeveri të hapur: përcaktim i agjendës së shoqërisë civile dhe monitorimi i planeve të veprimit” i cili financohet nga Bashkimi evropian.

Që të tri analizat e shkurtëra bazohen në evidenca të grumbullara përmes (1) monitorimit të faqeve të internetit të 19 institucioneve, (2) pyetësorëve të mbushur nga nëpunës civil në institucionet e përfshira dhe (3) një sondazhi të opinionit publik. Këtë vit Ambasada Britanike në Maqedoni e ka bashkë-financuar monitorimin e faqeve të internetit dhe publikimin e tre analizave të shkurtëra. Institucionet e përfshira në këtë hulumtim janë 15 ministritë e Qeverisë së Maqedonisë, Kuvendi, Sekretariati i Përgjithëshëm i Qeverisë, Fondi për sigurim shëndetësorë dhe Fondi për sigurim pensional dhe invalidor. Sondazhi i opinionit publik që CRPM e realizoi në shtator të vitit 2015 i ka shqyrtuar përvojat e qytetarëve dhe ndihmon në analizimin më të thellë dhe me më shumë këndvështrime mbi praktikat dhe politikat e qeverisjes. Përveç analizimit të përgjithëshëm të performancave të institucioneve në fushën e qeverisjes së mirë, kjo seri analizash gjithashtu e shqyrton nivelin e zbatimit të zotimeve kombëtare drejt Partneritetit për qeverisje të hapur (PQH), si dokument strategjik që i përmbledh përpjekjet e vendit për transparencë, llogaridhënie dhe pjesëmarrje qytetare më të madhe.

HYRJE

Cilido definicion i qeverisjes së mirë detyrimisht e vendos qytetarin në pozitën qendrore të qarkut si motori i qeverisjes dhe pronar i rezultateve të punës së saj. Meqë qytetarët janë tatim-paguesit, votuesit dhe pranuesit e shërbimeve përfundimtare, ata kanë të drejtë të plotë të kenë kontrollë të përgjithëshme dhe të jetë drejtëpërdrejtë të përfshirë në procesin e qeverisjes. Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaftë e gjerë, një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangëshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendrorë është *liria e informimit*. *Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin por gjithashtu sepse i fuqizon njerëzit dhe mundëson shpërndarje më të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithëshëm në vend, dhe e sfidon pushtimin e vazhdueshëm të këtyre përfitimeve nga elitat*.¹

Ky shkrim fokusohet në temën e transparencës institucionale, ose siç e quajnë Xhorxh Kopits dhe Jon Kreg (1998)² „aspekti administrativ i transparencës”, duke tentuar të vlerësojë dhe analizojë performancat e institucioneve në nivel qendror në bazë të disa indikatorëve që kanë të bëjnë me qasjen në informacione. Rezultatet e sondazhit të opinionit publik që e informojnë këtë analizë rreth qëndrimeve dhe përvojave të qytetarëve me institucionet qendrore gjithashtu kanë vlerë të rëndësishme për hulumtimin e përgjithëshëm.

Në fund, kjo analizë do t’i shqyrtojë dhe masat e Plan veprimit për PQH 2014-2016 (që ka për qëllim të përmirësojë qasjen e informacioneve me karakter publik në vend) për të analizuar ndikimin dhe sfidat e tyre në këtë fushë.

¹ Bellver A., Kaufmann D (2005), *Transparenting Transparency: Initial Empirics and Policy Applications*. The World Bank. September 2005.

² George Kopits and Jon Craig (1998), *Transparency in Government Operations*. International Monetary Fund. Washington DC, January 1998.

1. QASJE E INFORMACIONEVE PUBLIKE

1.1. Qasje e lirë e informacioneve (QLI)

Ligji maqedonas për qasje të lirë në informacione me karakter publik (Ligji për QLI) u miratua në vitin 2006 dhe u ndryshua disa here që atëherë (2008, 2010, 2014). Ai është ligj funksional dhe modern, dhe radhitet i 13-ti nga Rankimi global i të drejtës së informimit (Global Right to Information Rating) në mes të 102 shteteve.³ Në fakt, i shkruar, ky ligj paraqet një bazë të shëndoshë ligjore që i harmonizon të drejtën qytetare për të ditur dhe lirinë e qasjes në informacion, megjithatë zbatimi i tij ballafaqohet me sfida të vërteta. Komisioni për mbrojtjen e së drejtës për qasje në informacione me karakter publik (Komisioni për QLI), përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të ligjit në fjalë, rregullisht organizon trajnime dhe aktivitete për ndërgjegjësim të kërkuësve potencial të informacioneve sidhe të institucioneve që posedojnë informacione me karakter publik me qëllim që të përmirësohet shfrytëzimi publik i kësaj të drejte.

Një nga përparësitë kyçe të këtij ligji, kudo, është që synon transparence maksimale duke mos u kërkuar kërkuësve të informacioneve që të shpjegojnë arsyen përse e kërkojnë këtë informacion dhe duke e obliguar institucionin që i posedon informacionet të arsyetohet në rast të mos-hapjes së informacioneve. Kjo ndihmon drejt ndryshimit të qëndrimit të nëpunësve civil drejt informacionit që ata posedojnë duke e sfiduar qëndrimin që e trajton informacionin si pronë e tyre dhe jo si një vlerë që ata e menaxhojnë në emër të qytetarëve. Megjithatë ky qëndrim ngelet dominant në institucionet maqedonase. **Në vitin 2014, nga 849 ankesat e dorëzuara tek Komisioni për QLI, 785 nga to (92.5%) janë për të ashtuquajturën „qetësi administrative”, ose mospërgjigje nga institucioni brenda afatit kohorë të paraparë me ligj.**⁴ Komisioni për QLI gjithashtu raporton që ka ndryshim të shpeshtë të stafit përgjegjës për menaxhim të kërkesave për QLI, ku nëpunës të trajnuar zëvendësohen nga nëpunës pa trajnim adekuat, dhe kjo kontribuon drejt mosefikasitetit të institucioneve t’u përgjigjen kërkesave.⁵ Megjithatë, Komisioni është shumë i angazhuar përgjatë procesit dhe shpesh luan rolin e ndërmjetësuesit mes

- **92.5% e ankesave të pranuar nga Komisioni për QLI në vitin 2014 janë për qetësi administrative;**
- **84% e këtyre ankesave vijnë nga OSHC dhe fondacione;**
- **58.6% e ankesave kanë ardhur nga një OshC;**
- **Në vitin 2014, i institucionet – mbajtëse të informacioneve kanë pranuar 4551 kërkesa për QLI.**

³ Global Right to Information Rating. <http://www.rti-rating.org/country-data>

⁴ Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik (2015), „Raporti vjetor për punën e Komisionit për mbrojtjen e së drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2014”. Shkup, Mars 2015.

⁵ Ibid.

institucionit si posedues i informacionit dhe palës që kërkon QLI. Sipas raportit vjetor të Komisionit, ai ka ndërprerë procesimin e 406 ankesave (gati gjysma e gjithë ankesave të pranuar në vitin 2015) sepse me ndërmjetësim të Komisionit për QLI institucionet poseduese të informacionit e kanë ofruar informacionin e kërkuar, edhe pse pas afatit kohorë.

Në përgjithësi, ekzistojnë sfida të mëdha në procesin e pranimit të informacioneve nga institucionet publike në Maqedonia edhe përkundër aktiviteteve të vazhdueshme për ndërgjegjësim dhe ndërtim të kapaciteteve nga ana e Komisionit për QLI. Edhe nëntë vite pas miratimit të Ligjit për QLI ende ka institucione që nuk ofrojnë informacione për kontakt të personit përgjegjës për menaxhim me kërkesat për QLI, siç janë për shembull Ministria e transportit dhe lidhjeve dhe Ministria e mbrojtjes. Informacionet e tyre të kontaktit mund të gjenden në faqen e internetit të Komisionit për QLI por jo në ato të ministrive përkatëse. Nga ana tjetër, institucionet – mbajtëse të informacioneve nuk i raportojnë Komisionit për QLI siç janë të obliguar ligjërisht dhe shpesh herë, edhe pse mund ta dorëzojnë raportin vjetor, paraqesin të dhëna të pasakta ose të pakompletuara.⁶

Gjithashtu, është me rëndësi të përmendet se 84% e ankesave të dorëzuara tek Komisioni për QLI në vitin 2014 kanë ardhur nga organizata të shoqërisë civil dhe fondacione në vend, dhe vetëm 16% nga qytetarë individ. Në vitin 2014, në përgjithësi 4551 kërkesa për QLI u janë dorëzuar institucioneve – mbajtëse të informacioneve publike në vend. Të dhënat nga Komisioni për QLI përkojnë me të dhënat e mbledhura nga sondazhi i kryer nga CRPM, i cili zbulon se **vetëm 9.4% e të anketuarëve kanë dorëzuar ndonjëherë kërkesë për qasje në informacione publike.** Ndërgjegjësimi dhe shfrytëzimi i përgjithëshëm i Ligjit për QLI ngelet i ulët tek qytetarët. Në fakt, kjo e drejtë kryesisht praktikohet nga një numër i vogël i OShC-ve të cilat i ngarkojnë institucionet me një numër të madh kërkesash për një periudhë të shkurtër kohore dhe zakonisht dërgohen të gjitha në të njejtën kohë. Për shembull, Shoqata për emancipim, solidarizim dhe barazi të grave në Maqedoni – ESE ka dorëzuar 58.6% (498) të ankesave drejtuar Komisionit për QLI në vitin 2014.⁷ Ky numër ilustron që kuptimi dhe zbatimi i përgjithëshëm i QLI-së në vend ngelet shumë i ulët nga qytetarët.

⁶ Ibid.

⁷ Ibid.


1.2. Faqet e internetit si platforma kryesore për transparencë

Në epokën e internetit, kur shumica e institucioneve kanë faqe të internetit (të gjitha institucionet e përfshira në hulumtimin tonë kanë faqe të internetit), liria e informimit mund dhe duhet të praktikohet në mënyrë më proaktive dhe të vazhdueshme. Institucionet e kanë mundësinë dhe duhet të publikojnë sa më shumë informacione që është e mundur në faqen e tyre të internetit që t'i bëjnë ato funksionale dhe më informuese. Hapja e pjesës më të madhe të informacioneve në mënyrë proaktive mund të jetë një hap fillestar për uljen e numrit të kërkesave për QLI nga OShC-të dhe qytetarët, dhe në të njëjtën kohë të shërbejë për përmirësimin e komunikimi me to. Gjithashtu, institucionet mund t'i shfrytëzojnë faqet e internetit si platforma bazike për të publikuar të gjitha informacionet që kërkohen përmes QLI me qëllim që të rritet shpërndarja e të dhënave dhe transparenca e përgjithëshme e institucionit. Asnjë nga ministritë e Qeverisë së Maqedonisë ose institucionet tjera të përfshira në këtë analizë nuk i publikojnë kërkesat për QLI dhe përgjigjet përkatëse në faqet e tyre të internetit dhe shumica nuk kanë as pjesë të dedikuara për „pyetje të shpeshta”. Megjithatë, ekzistojnë dy faqe të tilla të internetit që ofrojnë mbështetje në lidhje me procedurën për parashtrimin e kërkesave dhe ankesave për QLI. Ata gjithashtu ofrojnë dhe një „bazë të njohurive” ku janë të paraqitura disa kërkesa dhe përgjigje të QLI. Këto faqe të internetit (www.spininfo.org.mk dhe www.slobodenpristap.mk) nuk mirëmbahen nga institucione publike por nga OShC lokale dhe mbështeten nga donacione nga jashtë.

1.2.1 Të dhëna të lexueshme nga makina

Ligji për QLI është themeli i parimeve të transparencës institucionale që synon t'i hap të dhënat që i posedojnë institucionet për qytetarët. Megjithatë, me përparimin e teknologjisë, standardet e transparencës kanë përparuar gjithashtu deri në nivel që të potencohet rëndësia e formatit në të cilin lëshohen të dhënat, me qëllim që rritet përdorshmëria e tyre. Dobia e të dhënave të lexueshme nga makina (kompjutri) shkon përtej bërjes së një informacioni të caktuar të

Vetëm 8% e të anketuarëve e kanë vizituar portalin www.otvorenipodatoci.gov.mk dhe 40.4% nga to nuk e dijnë që ekziston.



disponueshëm për publikun. Në fakt ato mundësojnë gjenerimin e informacioneve të reja dhe kjo sinqerisht kontribuon drejt kthimit të informacioneve që mbajnë institucionet tek qytetarët. Disa shtete i kanë ndyshuar ligjet e tyre për QLI që t'i obligojnë institucionet – mbajtëse të informacioneve t'i

publikojnë informacionet e kërkuara në format të hapur të lexueshëm nga makinat. Ndërsa në Maqedoni është miratuar një ligj i ri në vitin 2014 që quhet Ligji për përdorim të të dhënave nga sektori publik, i cili i obligon institucionet publike të publikojnë të dhëna që ata posedojnë dhe me të cilat punojnë në format të hapur që ato të mund të përdoren dhe përpunohen më tej nga qytetarët.

Momentalisht, ekzistojnë 154 sete me të dhëna të hapura në portalin e të dhënave të hapura, të publikuara nga 24 institucione.

Sigurisht, institucionet posedojnë shumë më shumë informacione se sa publikojnë në internet, qoftë në format të mbyllur ose të hapur. Megjithatë, duke e pasur parasysh që portali i të dhënave të hapura është lançuar në


vitin 2014, fakti që **për një vit 60% e ministrive kanë vërtetuar se kanë kapacitete teknike të punojnë me të dhëna të hapura** është shenjë progresi. Ministria e punës dhe politikës sociale radhitet e para sipas numrit të seteve me të dhëna të publikuara në portal (29), e ndjekur pas nga Ministria e ekonomisë me 21 sete të dhënash. Të dhënat e hapura kërkojnë angazhim proaktiv nga institucionet. Deri më tani, në përgjithësi institucionet kanë vendosur vet se cilat nga informacionet që ata posedojnë duhet të publikohen si të dhëna të hapura. Prandaj, ngelet të shohim nëse institucionet do të stimulohen të rrisin numrin e seteve me të dhëna dhe të përmirësojnë kualitetin e tyre me kalimin e kohës. Në të njëjtën kohë është me rëndësi që vetëdija publike për përdorimin e këtyre të dhënave të rritet dhe mjeti më i mirë për ta bërë këtë është politika edhe më transparente në institucione. Mosbesimi në përgjigjshmërinë (responsivitetin) e institucioneve ndaj kërkesave të qytetarëve është shkak kryesorë i qytetarëve jo-aktiv.

Edhe pse të dhënat e hapura të procesuara u shërbejnë shumë qytetarëve të zakonshëm, gjasat janë shumë të larta që numri i përdoruesëve të të dhënave të hapura asnjëherë nuk do të jetë shumë i madh meqë për të punuar me ato nevojiten aftësi speciale teknike. Prandaj, është me rëndësi të potencohet se edhe pse të dhënat e hapura dhe QLI mund ta plotësojnë njëra tjetrën, ata nuk e zëvendësojnë njëra-tjetrën. Institucionet sërisht duhet të investojnë shumë mund që ta përmirësojnë performancën e tyre me QLI, njëkohësisht përderisa përmirësojnë kapacitetet e tyre të punojnë me të dhëna të hapura. Në krahasim me të dhënat e hapura, në përgjithësi QLI funksionon në mënyrë reaktive, e bazuar në kërkesa, dhe u ofron qytetarëve të zakonshëm, gazetarëve, hulumtuesëve të drejtën për të patur qasje në informacione të caktuara që nuk janë paraprakisht të disponueshme në internet. QLI mund të jetë mjeti më praktik kur informacioni i kërkuar është një shpjegim tekstual. Gjithashtu, vlera e shtuar e QLI është se i lajmëron institucionet për atë se cilat informacione më së shumti i interesojnë shoqërisë.

1.2.2 Çfarë informacione publikojnë institucionet?

Deri më tani, faqet e internetit janë mënyra më e mirë që institucionet mund ta përdorin për transparencë publike dhe komunikim efikas me qytetarët. Investimi në kualitetin e interfejsit dhe informacioneve që ata përmbajnë do ta rriste numrin e vizitorëve dhe do të rriste performancën e institucioneve në përmbushjen e standardeve të transparencës. Penetrimi i internetit në Maqedoni është i lartë (68.3%) dhe është në rritje konstante.⁸ Vendi rradhitet i 36-i në Europë dhe i 60-i në botë për penetrimin e internetit.⁹ Sipas sondazhit tonë, 71.1% e qytetarëve përdorin telefona të mençur. Këto rrethana kërkojnë që institucionet të përfitojnë më shumë nga mundësitë që ofrojnë teknologjia dhe interneti me qëllim që të afrohen dhe të jenë më të hapur me qytetarët. Prandaj, shpallja e të dhënave në tabelën e shpalljeve para portave të institucioneve nuk është arsyeim për mosparaqitjen e të njëjtave informacione në faqet e internetit ku mund të arrihet një numër më i madh i qytetarëve të interesuar. Gjithashtu, ekzistojnë mekanizma për t'i njoftuar ata kur publikohen të dhëna të reja.

- **Penetrimi i internetit në Maqedoni arrin 52%, rradhitet e 36-ta në Europë dhe e 60-ta në botë.**
- **71.1% e qytetarëve përdorin telefona të mençur.**




Sondazhi i CRPM-së tregon që faqet e internetit të institucioneve nuk janë mes mediumeve më të preferuara të qytetarëve për tu informuar me punën e institucioneve, megjithatë, numrat ndryshojnë sipas moshës dhe arsimit. Të anketuarit në grup-moshën 18-34 i preferojnë portalet në internet si burim informimi për aktivitetet e institucioneve qendrore, dhe pastaj televizionin, faqet e internetit të institucioneve dhe në fund profilet në Fejsbuk të institucioneve.

⁸Enti shtetërorë për statistika (2015), Maqedonia në numra.

<http://www.stat.gov.mk/Publikacii/MakBrojki2015m.pdf>

⁹ Maqedonia rradhitet e 36-a sipas numrit të shfrytëzuesëve të internetit. *Nova Makedonija*. 02.02.2015.

<http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=2215934209&id=10&setIzdanie=23384>



Në grup-moshën 35-54 dhe mbi 55 televizioni është burimi i informimit i preferuar dhe pastaj portelet në internet, edhe pse me dallim drastik (27% dhe 8.2% respektivisht). Në përgjithësi, 32.5% e të anketuarëve thonë se i vizitojnë faqet e internetit të institucioneve në nivel qendror edhe pse shumica e tyre e bëjnë atë rallë (25.1%). Duke e pasur parasysh që shumica e shërbimeve publike janë të decentralizuara, nuk befason numri i vogël i vizitave në faqet e internetit të institucioneve qendrore. 32.5% është përqindje e kënaqëshme e popullsisë që viziton faqet e internetit të institucioneve qendrore. Informacionet kryesore që qytetarët mund t'i kërkojnë nga institucionet qendrore kanë të bëjnë me obligimin e tyre për të qenë transparent dhe llogaridhënës ndaj qytetarëve dhe jo aq shumë me shërbimet direkte që u ofrohen atyre. Nëse i bashkojmë përgjigjet „po, shpesh” dhe „po, rrallë” *sondazhi tregon që ka një korelacion pozitiv mes nivelit të arsimit dhe shprehisë për të vizituar faqet e internetit të institucioneve.*

Ata që i vizitojnë faqet e internetit më shpesh e lexojnë pjesën e lajmeve (83%).

Televizioni, portalet në internet dhe media tjera të masave nuk mund ta zëvendësojnë hapsirën që e ofrojnë faqet e internetit për institucionet që të ndajnë me qytetarët në mënyrë të detajuar dokumente strategjike, procedurat e tendereve, raportet financiare, raporte për aktivitete ditore dhe shumë më shumë.

Qytetarët mendojnë se është e rëndësishme që institucionet të publikojnë:

Plan për prokurim publik (63%)

List të kompanive të papërshtatshme të konkurojnë në tender përshkak të konfliktit të interesave (46.7%).

Pjesa e vetë institucionit nga buxheti shtetëror (66%)

Shpjegim për lidhjen mes planit strategjik dhe buxhetit të miratuar (54%)

Raport financiar të gjysmë-vitit (59.2%).

Sigurisht, qytetarët mund të mos i shikojnë këto dokumente shpesh përderisa nuk ndjehen të ndikuar nga ato rregullisht në mënyrë të drejtëpërdrejt (përveç nëse j'u interesojnë profesionalisht), dhe sa u përket aktiviteteve të institucioneve, disa nga këto informacione arrijnë deri tek qytetarët përmes mediave të masave edhe më të shkurtuara. Ata që thonë se i vizitojnë faqet e internetit të institucioneve qendrore gjithashtu thonë se më shpesh e lexojnë pjesën e lajmeve (80.45%), dokumentacionin për prokurim publik (54.2%), thirrje për bursa, subvencione, donacione (70.6%).

Megjithatë, shumica (përfshirë dhe ata që thonë se asnjëherë nuk i vizitojnë faqet e internetit të institucioneve qendrore) janë të mendimit se informacionet strategjike janë të rëndësishme dhe relevante që të publikohen në faqet e internetit të institucioneve. Për shembull, 63% mendojnë se është me rëndësi që institucionet qendrore të publikojnë plan për prokurim publik dhe 46.7% mendojnë se institucionet duhet të publikojnë një listë të kompanive të cilat nuk mund të garojnë për tender për shkak të konfliktit të interesave. Sidoqoftë, asnjë nga ministritë dhe vetëm Fondi për sigurim shëndetësor (nga 19 institucionet që i kemi monitoruar) kanë publikuar plan për prokurim publik në faqen e tyre të internetit, dhe asnjëra nga to nuk ka deklarata për mungesë të konfliktit të interesave.¹⁰ Gjithashtu, qytetarët e konsiderojnë të rëndësishme që institucionet në nivel qendror ta publikojnë pjesën e tyre të buxhetit shtetëror (66%), shpjegim të lidhjes mes planeve strategjike të qeverisë dhe buxhetit të miratuar (54%), sidhe raporte gjysmë-vjetore (59.2%). Qytetarët e konsiderojnë të rëndësishme që institucionet të ndajnë informacione për aktivitete dhe plane në vijim, mirëpo institucionet sërisht nuk publikojnë dokumente dhe informacione shumë të rëndësishme për qytetarët, gjë që e rrit distancën dhe mosbesimin mes tyre. Monitorimi i faqeve të internetit nga CRPM tregoi se vetëm 8 nga 15 ministritë kanë publikuar plan strategjik valid të institucionit, nëpërmjet si cilave qytetarët mund të mësojnë për prioritetet dhe qëllimet e aktiviteteve të institucioneve. Në fakt, institucionet janë të obliguara t'i bëjnë publike të gjitha dokumentet e përmendura më lartë, gjë që i tejkalon preferencat e qytetarëve për t'i bërë ato të disponueshme në faqet e internetit të institucioneve.

Kjo ilustron që mungesa e shprehisë dhe interesimit të qytetarëve t'i vizitojnë faqet e internetit gjithashtu vjen si pasojë e faktit se, shpeshherë, dokumentet strategjike ose mungojnë ose janë shumë rëndë për t'u gjetur duke kërkuar në faqen e internetit. Prandaj, edhe më shumë është e rëndësishme që institucionet të bëjnë publike strukturën organizative dhe informacione për kontakt të sektorëve të ndryshëm brenda ministrive, që qytetarët të dijnë ku të drejtohen për shqetësime të ndryshme. Në fakt, 8 ministri, Kuvendi, Fondi për sigurim shëndetësor dhe Fondi për sigurim penzional dhe invalidor japin informacione për kontakt të së paku disa sektorëve brenda institucionit, përveç emailit të përgjithshëm, ndërsa sa u përket strukturës organizative, 10 ministri e kanë të paraqitur atë në faqen e tyre të internetit.

Ekziston nevojë e përgjithëshme për t'i bërë faqet e internetit më interaktive dhe më të pasura me informacione, por vendosja e mjeteve që u lejojnë personave me aftësi të kufizuara qasje të barabartë në informacionet e njejta thërret për vëmendje urgjente. Kjo e drejtë themelore e qasjes në dokumente strategjike, informacione për kontakt dhe të tjera, me patjetër duhet t'u ofrohet dhe personave me dëmtim të të dëgjuarit, të shikimit dhe të tjera. **Nga monitorimi i faqeve të internetit, CRPM munda të identifikojë vetëm një – Ministria e ambientit dhe planifikimit hapsiror – nga 19**

¹⁰ Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave (2015). Indeksi i qeverisjes së mirë në Maqedoni. Dhjetor 2015.

institucione, të cilat ofrojnë mundësinë për të rritur madhësinë e tekstit. Asnjë tjetër mjet nuk u identifikua në asnjë faqe të internetit.

Institucionet janë vetë përgjegjëse për matjen e interesit publik, duke i konsideruar me kujdes kërkesat për QLI dhe për të dhëna të hapura dhe duke bërë përpjekje për t'i bërë këto informacione për të cilat intereson qytetarët të disponueshme paraprakisht dhe t'i azhurojnë ato në kohë. Përfshirja e qytetarëve dhe përgjigja ndaj interesave të tyre sigurisht që do ta rriste interesimin qytetar për faqet e internetit të institucioneve. Është e rëndësishme që institucionet qendrore t'u lejojnë palëve të interesuara të regjistrohen për të pranuar bulletin informativ dhe lajmërimi të tjera për institucionet, duke u siguruar kështu që qytetarët informohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe në kohë për aktivitetet që j'u interesojnë atyre dhe nuk ka nevojë t'i kërkojnë në faqen e internetit. **Deri më tani, vetëm dy ministri dhe Kuvendi e ofrojnë shërbimin për tu regjistruar për bulletin informativ.**

2. PLAN VEPRIMI PËR 2014-2016 DHE TRANSPARENCA

Ndikimi që iniciativa Partneritetit për qeverisje të hapur ka mbi qeveritë kudo në botë rritet nga viti në vit. Qeveritë vazhdimisht po mësojnë si ta përshtatin atë me rrethanat në vendet e tyre dhe ta shfrytëzojnë sa më mirë. Për shembull, Maqedonia i filloi përpjekjet e veta për të dhëna të hapura si rezultat i drejtpërdrejtë i iniciativës PQH dhe në plan veprimi e saj të parë 2012-2014, anëtarësimi në PQH u arsyetua kryesisht me përfitimet që mund të vijnë nga të dhënat e hapura. PQH gjithashtu i ka dhënë zë thirrjes së shoqërisë civile për transparencë dhe përfshirje më të afërt të palëve të interesuara në proceset e vendimmarrjes.

Ajo që ka ndryshuar me planin e dytë të veprimit për PQH (2014-2016) në Maqedoni është formimi i grupeve të punës për secilin nga gjashtë prioritetet e planit të veprimit. Anëtarët e grupeve janë përgjegjës për implementimin e masave specifike brenda prioritetit që ata udhëheqin, dhe një numër i madh i tyre vijnë nga shoqëria civile. Ka shumë vërejtje për punën e grupeve të punës si dhe për implementimin e përgjithshëm të plan veprimit, megjithatë, meqë PQH i përfshin vlerat e qeverisjes së mirë të cilat i shqyrton kjo seri e analizave, plan veprimi për PQH 2014-2016 gjithashtu analizohet këtu.

Paragrafet në vijim kanë për qëllim që t'i paraqesin masat e ndërmara në vend si angazhim ndaj PQH-së, të cilat kontribuojnë në ngritjen e transparencës së institucioneve, gjegjësisht, e përmirësojnë qasjen në informacionet që i posedojnë institucionet.

2.1. Liria e informimit

Prioriteti i tretë është i përkushtuar në masa që kanë për qëllim të përmirësojnë zbatimin e Ligjit për QLI. Palët implementuese të këtij prioriteti janë Ministria e drejtësisë, Komisioni për QLI dhe disa OShC. Dy masat e para fokusohen në nevojën për të ngritur ndërgjegjësimin tek kërkuarët e informacioneve dhe kapacitetet tek institucionet – mbajtëse të të dhënave. OShC kryesisht kanë punuar me gazetarë, OShC, studentë për t'i njoftuar ata me të drejtat e tyre dhe me procedurat e kërimit të qasjes në informacione të karakterit publik. Nga ana tjetër, Komisioni për QLI ka mbajtur disa trajnime për nëpunësit përgjegjës për menaxhim me kërkesat për QLI, për gjykatat dhe prokurorët në vend. Trajnimet për QLI janë të vazhdueshme në Maqedonia që nga miratimi i Ligjit për QLI, prandaj është për të ardhur keq që procesi i garantimit të kësaj të drejte për qytetarët vazhdon të ketë aq shumë dobësi. Si pasojë, edhe pse janë kompletuar masat e plan veprimit që kanë të bëjnë me trajnime, nuk është shumë e qartë nëse ata kanë

Si përpjekje për të përmirësuar sasinë dhe cilësinë e informacioneve që ofron Komisioni për QLI ajo ka fituar një ueb-lokacion të ri me mbështetjen e Ministrisë së shoqërisë informatike dhe administratës (masa 3.3). Komisioni do të pranojë një shumë shtesë prej 500 000 MKD në buxhetin e tij meqë pesë anëtarë të ri do t'i shtohen stafit deri vitin e ardhshëm (masa 3.6). Disa OShC sidhe raporti i progresit nga Komisioni evropian¹¹ rekomandojnë zgjerimin e përgjegjësisë të Komisionit që ai të mund të vendos ndëshkime për institucionet që nuk i përmbahen Ligjit për QLI, por plan veprimi për PQH ka

¹¹ European Commission (2014), the former Yugoslav Republic of Macedonia Progress Report. October 2014. http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report_en.pdf

synuar vetëm drejt rritjes së stafit. Plan veprimi gjithashtu e inkurajon bashkëpunimin e Komisionit për QLI me OShC përmes nënshkrimit të memorandumëve për bashkëpunim (masa 3.7). Ky zotim vjen si aktivitet i planifikuar paraprakisht nga projekt i caktuar i ndonjë OShC-je dhe duhet të realizohet deri në dhjetor. Megjithatë, ky aktivitet do të realizohet edhe sikur plan veprimi për PQH të mos ekzistonte prandaj nuk mund të analizohet si rezultat i drejtpërdrejtë i masave të plan veprimit për PQH.

Liria e informimit	
Masa	Niveli i kompletimit
3.1. Ngritja e ndërgjegjësimit për të drejtën e qasjes së lirë përmes paraqitjeve në medium dhe kampanjave educative.	E kompletuar
3.2. Edukimi i nëpunësve si mbajtës të informacioneve (Komisioni për mbrojtjen e së drejtës për qasje të lirë në informacione të karakterit publik)	E kompletuar
3.3. Faqe e re e internetit për Komisionin për QLI (Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës)	E kompletuar
3.4. Postimi dhe azhurimi i vazhdueshëm i listës së mbajtësve të informacioneve	Pjesërisht
3.5. Disponueshmëria e informacioneve publike në faqet e internetit të mbajtësve të informacioneve	Pjesërisht
3.6. Përmirësimi i burimeve njerëzore dhe financiare të Komisionit për QLI.	Pjesërisht
3.7. Rritja e bashkëpunimit të Komisionit me shoqata, fondacione dhe komuna në Republikën e Maqedonisë përmes Memorandumeve për bashkëpunim.	E pa filluar
3.8. Publikimi i informacioneve për implementimin buxhetor dhe programor të buxheteve shëndetësore, me fokus të veçantë në implementimin buxhetor dhe financiar të programeve preventive të Ministrisë së shëndetësisë, të cilat janë marrë nëpërmjet procedurës për QLI.	E kompletuar
3.9. Ndryshim dhe plotësim i Ligjit për qasje të lire në informacione të karakterit publik	E pa filluar
3.10. Themelimi i grupit ndërsektorial të punës për të vërtetuar pajtueshmërinë e Konventës së Këshillit të Europës për qasje në dokumente publike dhe vërtetim të kushteve ligjore nacionale për t'u përfshirë në këtë konventë.	E pa filluar

Masa tjera tentojnë që të nxisin institucionet – mbajtëse të informacioneve publike të risin disponueshmërinë e informacioneve në faqet e internetit të institucioneve. Shumë institucione vazhdojnë të mos i azhurojnë listat e informacioneve me karakter publik që ata i posedojnë ose nuk e publikojnë atë fare në faqen e tyre të internetit edhe pse masa 3.4 kishte për qëllim pikërisht rritjen e numrit të institucioneve që publikojnë informacione të tilla. Një studim i ndërmarrë nga Shoqata për emancipim, solidarizim dhe barazi të grave (ESE) e vërteton këtë meqë kanë ardhur në përfundim se vetëm 5 (ose 27%) nga 18 faqet e internetit të institucioneve që ata kanë monitoruar (që janë ndryshe nga institucionet e monitoruara nga CRPM) përmbajnë listë të informacioneve publike që ata posedojnë.¹² Gjithashtu, siç është diskutuar më lartë, shumë institucione nuk arrijnë të publikojnë informacione me karakter publik në mënyrë proaktive në faqet e tyre të internetit – qoftë dhe dokumente strategjike si programet, buxhetin, prokurimet publike dhe raporte financiare. ESE e ka nxitur Ministrinë e shëndetësisë që të bëjë publike informacione për programet shëndetësore të implementuara nga Ministria dhe buxhetet e tyre duke kërkuar informacione përmes procedurës për

¹² Association for Emancipation, Solidarity and Equality of Women in Macedonia.
<http://www.esem.org.mk/pdf/Publikacii/2015/ESE%20transparency.pdf>

QLI. Të njëjtat informacione tani janë publike në faqen e internetit të Ministrisë së shëndetësisë – që e kompletën me sukses masën 3.8.

Disa OShC i kanë kërkuar Ministrisë së Drejtësisë të merr iniciativën për të ndryshuar ligjin për QLI, por asnjë aktivitet nuk është ndërmarrë në këtë drejtim (3.9). Ngjashëm. Masa 3.10 gjithashtu është e pafilluar edhe pse është masë që vazhdon nga plan veprimi i kaluar për PQH 2012-2014. Kjo masë ka të bëjë me ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për qasje në dokumente publike të cilat Maqedonia tani më i ka nënshkruar. Kjo nuk përmendet në asnjë nga raportet zyrtare tremujore ose gjysmë-vjetore të qeverisë për implementimin e plan veprimit për PQH 2014-2016.

Me sa duket, deri më tani masat e ndërmarra kanë ndikim të kufizuar në përmirësimin e përgjithshëm të disponueshmërisë së informacioneve publike për qytetarët. Vetëm azhurimi i faqes së internetit të Ministrisë së shëndetësisë për të paraqitur informacione të rëndësishme për punën e saj mund të përmendet si masë e kompletuar me sukses dhe si masë me ndikim që dukshëm e ka përmirësuar disponueshmërinë e informacioneve publike në faqen e internetit të Ministrisë në fjalë.

Edhe pse procesi i hartimit të plan veprimit 2014-2016 ishte mjaft më i mirë se ai paraprak, matshmëria dhe ndikimi i masave të tij janë pothuajse po aq të dobëta sa të planit të parë. Është përmendur në një analizë më të herëshme të CRPM-së se një nga problemet kyçe të plan veprimit për PQH 2014-2016 është fakti se shumica e masave të tij janë angazhime që ekzistojnë që më herët në dokumente të tjera strategjike të institucioneve të përfshira në process ose në aktivitetet e planifikuara të projekteve të OShC-ve, dhe vetëm pak nga to janë të menduara enkas për PQH. Prandaj dhe ndikimi i tyre në ngritjen më lartë të shtyllave të PQH, në rastet më të mira, është i kufizuar.

2.2. Të dhëna të hapura

Informacionet që i paraqesin të dhënat e hapura nuk i shërbejnë detyrimisht qëllimit për t'i bërë institucionet më transparente dhe llogaridhënëse, por ata mbajnë vlerë të madhe për shoqërinë (kur janë të procesuara) dhe praktikisht, ua kthejnë qytetarëve statistikën e tyre. Prandaj, më poshtë do ta diskutojmë prioritetin e dytë në plan veprimit të PQH, të dhëna të hapura, që shkurtimisht të analizojmë nëse implementimi i këtij prioriteti ka kontribuar deri më tani në rritjen e disponueshmërisë së informacioneve publike që i posedojnë institucionet.

Të dhëna të hapura	
Masa	Niveli i kompletimit
2.1. Të hapen të dhënat e organeve dhe institucioneve publike	E kompletuar
2.2. Vendosija e standardeve teknike për formatin e të dhënave dhe mënyrën e publikimit të tyre	E kompletuar
2.3. Krijimi i një katalogu qendror për të dhënat e sektorit public të publikuara për përdorim.	E kompletuar
2.4. Krijimi i një baze të dhënash për kontakt-personat në organet dhe institucionet publike ku janë nominuar kontakt-persona përgjegjës për adaptimin teknik dhe publikimin e të dhënave për përdorimë sidhe për azhurimin e vazhdueshëm të katalogut të të dhënave www.otvorenipodatoci.gov.mk	?
2.5. Paraqitja e mundësisë për dorëzim të kërkesave nga palët e interesuara për publikim të bazave të reja të të dhënave.	E kompletuar
2.6. Krijimi i një platforme për kryqëzim të të dhënave (data mashing) – pilotim me 11 institucione.	E kompletuar
2.7. Trajnime për implementimin e Ligjit për përdorim të të dhënave nga sektori publik	E kompletuar

Palët implementuese të të gjitha masave në këtë prioritet janë institucionet shtetërore, kryesisht Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës (MSHIA). Dy OShC që marrin pjesë në këtë grup punues janë aty vetëm për konsultim dhe vëzhgim.

Të gjitha masat e këtij prioriteti janë të kompletuara sepse janë angazhime që ekzistojnë që më parë dhe janë të planifikuara nga buxheti i shtetit. Siç ka qenë e planifikuar, një platformë për publikimin e të dhënave të hapura nga të gjitha institucionet është krijuar dhe lejon kryqëzimin e deri më tre sete të dhënash. Numri i institucioneve që kanë publikuar sete të dhënash ka arritur në 24 këtë vit dhe nëndërkohë ka përpjekje të vazhdueshme për të përfshirë më shumë institucione të publikojnë të dhënat që ata mbledhin dhe me të cilat punojnë. Kjo platformë gjithashtu u lejon palëve të interesuara të kërkojnë publikimin e seteve të reja me të dhëna përmes një procedure të rregulluar.

Sipas raportit të Qeverisë për vetë-vlerësim të implementimit të plan veprimit për PQH 2014-2016 një katalog i kontakt-personave nga institucionet përgjegjëse për menaxhim me të dhëna të hapura dhe me kërkesat për të publikuar sete të reja është krijuar por një dokument i tillë nuk mund të gjendet në portalin e Qeverisë për të dhëna të hapura.

Nga ana tjetër, është hartuar një rregullore që i definon aspektet teknike të publikimit të të dhënave nga institucionet që është e bashkangjitur me Ligjin për përdorim të të dhënave nga sektori publik i cili i obligon institucionet të publikojnë sete të dhënash të hapura.

Përpjekjet për të krijuar një ambient që u mundëson institucioneve të ndajnë sete me të dhëna të hapura rrumbullakësohen me trajnimet për ngritjen e kapaciteteve të mbajtura nga MShIA në bashkëpunim me Institutin e të dhënave të hapura (Open Data Institute) nga Mbretëria e Bashkuar. Njëkohësisht, Fondacioni Metamorfoza ka mbajtur trajnime për OShC që kanë kontribuar drejt ndërgjegjësimit dhe ndërtimit të kapaciteteve për përdorimin e të dhënave të hapura, edhe pse ky aktivitet nuk ishte i përfshirë në plan veprimin e PQH 2014-2016.

Edhe pse të gjitha masat ndihmojnë drejt krijimit të kushteve për publikimin e më shumë seteve me të dhëna, vetëm masa e parë që ka të bëjë specifikisht me hapjen e seteve me të dhëna nga institucionet ka një ndikim të dukshëm në sasinë e informacioneve të arritshme dhe është drejtëpërdrejt përgjegjëse për që të 154 setet e të dhënave të disponueshme në platformën në internet. Këto të dhëna kanë rëndësi të posaçme për hulumtues dhe të tjerë që mund t'i shfrytëzojnë profesionalisht, por dobia e tyre për popullsinë e gjerë rritet kur ato përdoren në aplikacione të ndryshme. Megjithatë, suksesi i publikimit të seteve të të dhënave të hapura do të matet nga kreativiteti i aplikacionit që do t'i shfrytëzojë këto të dhëna. Vitin e kaluar Microsoft organizoi Hakaton të të dhënave të hapura ku pjesëmarrësit u inkurajuan që të krijojnë aplikacione duke u bazuar në setet e të dhënave që janë të disponueshme në portalin qeveritar të të dhënave të hapura. Edhe pse ky aktivitet nuk është pjesë e plan veprimit të PQH 2014-2016, ai ka ndihmuar në bërjen e informacioneve publike të poseduara nga institucionet qendrore të dobishme për popullsinë e gjerë. Tre aplikacionet që janë shpërblyer në këtë ceremoni janë: nowPARK.me (i informon shfrytëzuesit për hapsirat më të afërta të parkimit), Smart Phonebook (i informon shfrytëzuesit nëse një kontakt i tyre e ka ndryshuar operatorin dhe sa kjo do ju kushtonte atyre kjo thirrje), CultureApp (i informon shfrytëzuesit për repertoarin e të gjitha kinemave dhe teatrove në vend).

PËRFUNDIM

Çfarëdo përpjekje për të përmirësuar disponueshmërinë e informacioneve në faqet e internetit të institucioneve duhet së pari ta trajtojë bindjen e përgjithëshme se transparenca i bën institucionet më të cenueshme së bashku me besimin që informacionet që i posedojnë institucionet u takojnë atyre. (1) *Mungesa e transparencës së kënaqëshme mund të jetë pjesërisht e ndërlidhur me ndërgjegjshmërinë e ulët për vlerat potenciale të sasisë së madhe të informacioneve që institucionet i posedojnë dhe me të cilat punojnë.* Institucionet maqedonase ende po e rimarrin veten nga besimi që shpallja e raporteve ose dokumenteve strategjike për disa ditë në tabelën e shpalljeve tek hyrja e ndërtesës është një mënyrë e pranueshme dhe e mjaftueshme e të qenurit transparent dhe llogaridhënës ndaj qytetarëve. Në shumë raste tabela e shpalljeve dhe faqet e internetit kuptohen sikur e zëvendësojnë njëra tjetrën meqë në një mënyrë formalisht e plotëson detyrimin e publikimit të një dokumenti edhe përkundër faktit që tabela e shpalljeve ka qasje vetëm tek një audiencë shumë e kufizuar. Si pasojë, kultura institucionale e publikimit të më shumë informacioneve të detajuara, praktikisht, është shumë e kufizuar. Siç është përmendur, ekzistojnë dallime të mëdha mes performancave të institucioneve në nivel qendror ku disa janë më të hapura se të tjerat edhe pse të gjitha e përfaqësojnë të njëjtën qeveri. Por, sërisht, është legjitime të gjeneralizohet se shumica e institucioneve nuk arrijnë të publikojnë dokumente strategjike bazike siç janë buxhetet e tyre, raportet financiare gjysmëvjetore ose planet për prokurim publik.

Një arsyetim tjetër për sfidat e institucioneve në këtë drejtim janë kapacitetet e ndryshme teknike/administrative të institucioneve së bashku me vëmendjen e kufizuar që institucionet qendrore u japin marrëdhënieve me publikun. Në veçanti kur flasim për transparencën institucionale dhe shtyllat tjera të qeverisjes së mirë është me rëndësi të dallohet mes fshehtësisë së qëllimshme dhe mungesës së njohurisë dhe ndërgjegjësimit të nëpunësve civil për rëndësinë e një procesi të caktuar. Kapacitetet teknike të institucioneve që të mbajnë të azhuruar faqen e internetit dhe të komunikojnë në mënyrë efektive me qytetarët përmes kërkesave për QLI ose formave tjera të komunikimit dallojnë shumë dhe këto bëhen të dukshme kur jemi në kontakt të drejtpërdrejtë me institucionet. Kapaciteti përgjithësisht i dobët menaxherial dhe teknik është pjesë e zinxhirit të problemeve të administratës që e sfidojnë efikasitetin e saj në të gjitha aspektet, dhe sigurisht zinxhiri fillon me politikat e rekrutimit që praktikohen në vend. Megjithatë, vlen të përmendet se ajo që e bën dallimin mes performancës së institucioneve në fushën e transparencës janë politikat e brendëshme dhe ajo se sa shumë ata i japin vlerë të qenurit transparent dhe të përgjigjshëm ndaj qytetarëve. Për fat të keq, shumë raporte tregojnë që nëpunësit civil në Maqedoni shpesh herë nuk veprojnë me llogaridhënie ndaj qytetarëve dhe shpesh herë komunikimi dhe bashkëpunimi i tyre me qytetarët është shumë i rëndë – në disa institucione më shumë se në të tjera. Siç është diskutuar në këtë shkrim, kjo ndodh dhe me përgjigjet ndaj kërkesave për QLI kur nëpunësit civil shpesh herë pa të drejtë e paraqesin informacionin e kërkuar si konfidencial që nuk mund t'i jepet palës kërkuuese.

Nëse transparenca dhe marrëdhëniet me publikun do të ngjiteshin lartë në listën e prioriteteve të udhëheqësive të institucioneve publike, ka shumë gjasa që shumica e problemeve të përmendura në këtë shkrim së paku do të zbuteshin. Edhe pse buxheti shtesë mund të nevojitet ose mund të jetë një nga shkaqet e sfidave momentale, ai sigurisht nuk është një nga problemet kryesore. Për shembull, ndryshimet organizative që do i detyronin nëpunësit përgjegjës për QLI ta bënin punën e tyre mirë, me siguri nuk pengohen për arsye financiare. Në anën tjetër, interfejsët interaktive dhe lehtë të

përdorueshme të faqeve të internetit sidhe aplikimi i programeve të posaçme që u lejon qytetarëve me dëmtime të shqisave të shikimit ose dëgjimit qasje për informim mund të kërkojnë buxhetim special por nuk janë rëndë për tu arritur. Pamarrë parasyshë, asnjë arsye që ka të bëjë me financat pse preferencat nuk mund ta arsyetojë mungesën e dokumenteve strategjike në faqet e internetit ose sasinë e vogël të informacioneve të disponueshme në faqet e internetit të institucioneve qendrore. Përshtypja e përgjithëshme është se institucionet nuk investojnë shumë mund në përmirësimin e marrëdhënieve me publikun ose në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve, prandaj nuk është befasi që interesimi i qytetarëve që të vizitojnë faqet e internetit të institucioneve është shumë i ulët.

Prandaj, që me të vërtetë të garantohet qasja publike në informacione me karakter publik është shumë e rëndësishme që qeveria të miratojë standarde për informacionet që institucionet janë të obliguara dhe të inkurajua t'i ndajnë. Regullat duhet të sigurojnë se sa i përket lirisë së informimit, liria e vendosjes së institucioneve për atë se çfarë informacione të ndajnë me publikun duhet të jetë minimale. Deri më tani shoqëria civile në vend ka luajtur rol shumë aktiv në udhëzimin dhe nxitjen e institucioneve që të jenë më transparente dhe llogaridhënëse ndaj qytetarëve duke e monitoruar performancën e tyre dhe duke ofruar rekomandime sidhe kritika. Sigurisht, disa nga praktikatat e mira të institucioneve janë drejtpërdrejt të ndikuara nga këto bashkëpunime.

Plan veprimi i PQH përbëhet nga aktivitete që dukshëm e prioritetizojnë disponueshmërinë publike të informacioneve dhe transparencën e institucioneve, megjithatë kjo nuk e bën atë inovativ ose origjinal si dokument strategjik. Siç është potencuar nga analiza tjera të CRPM-së, plan veprimi i PQH është koleksion i masave që kanë ekzistuar dhe më parë nga dokumente tjera strategjike ose aktivitete projektsh të shoqërisë civile. Aktivitete të ngjashme ka pasur për një kohë të gjatë në vend edhe para plan veprimit të PQH 2014-2016 ose po ndodhin në të njejtën kohë paralelisht me plan veprimin edhe pse kanë për synim të njejtat qëllime. Sidoqoftë, një ndryshim i veçantë që aktivitetet e lidhura me anëtarësimin e vendit në PQH kanë sjellur, sa i përket transparencës, është qëndrimi se të gjitha informacionet që institucionet i posedojnë janë relevante dhe u takojnë qytetarëve. Në fakt, në këtë mënyrë të dhënat e hapura provomohen dhe arsyetohen. PQH gjithashtu e ka përfshirë dhe shoqërinë civile aq afër sa, si një vlerë e shtuar, PQH shërben si një platformë bashkëpunimi mes nëpunësve publik dhe organizatave të shoqërisë publike ku sfidat e institucioneve diskutohen haptazi dhe në mënyrë konstruktive.

Siç „rezikojnë” institucionet të jenë më transparente, qoftë si pasojë e presionit të jashtëm ose politikave të brendëshme, përfitimet publike bëhen më të dukshme me kalimin e kohës. Transparenca, jo vetëm që nuk i bën institucionet e cënueshme por dhe e përmirëson rezultatin e punës së tyre duke i hapur ato për kontrollë dhe komente nga publiku. Vetëm zhvillimi i sistemeve transparente që vazhdimisht, jo kohë pas kohe, publikojnë dhe azhurojnë informacione për punën e institucioneve do ta fitojnë interesin publik dhe kështu do të kontribuojnë në cilësinë e përgjithëshme të politikave të institucioneve.

REKOMANDIME

Për të gjitha institucionet në nivel qendrorë:

- **Qeveria duhet të vendos standarde për institucionet qendrore rreth asaj se çka duhet dhe çka janë të obliguara të publikojnë në faqet e tyre të internetit.**
- Reforma të thella organizative në administratën publike me theks të veçantë në politikat e rekrutimit të cilat do ta përmirësonin ndjeshëm transparencën institucionale.
- Përforcimi i llogaridhënies së administratës ndaj qytetarëve duhet të bëhet politikë e brendëshme prioritare e udhëheqësisë së secilit institucion. Përmirësimi i marrëdhënieve me publikun do e risë ndjeshëm besimin e qytetarëve në institucione.
- Të krijojnë regulla të brendëshme për atë se si ta parandalojnë dhe menaxhojnë konfliktin e interesave.
- Institucionet duhet të investojnë në përmirësimin e interfejsit të faqeve të tyre të internetit për t'i bërë ato më lehtë të përdorueshme sidhe të sigurojnë mjete për ta mirëmbajtur atë vazhdimisht.
- Institucionet duhet të lejojnë regjistrim për bulletin informativ elektronik dhe lajmeve të tjera për të përmirësuar marrëdhënies me palët e interesuara.
- Institucionet duhet të fillojnë urgjentisht me përdorimin e programeve që u lejojnë qytetarëve me aftësi të kufizuara qasje të barabartë në të gjitha informacionet.
- Institucionet duhet të ndjehen të inkurajuara t'i përfshijnë OShC-të që punojnë në fushën e transparencës t'i ndihmojnë ato me zhvillimin e politikave të brendëshme efikase për transparencë më të lartë.
- Institucionet- mbajtëse të informacioneve publike – duhet të përdorin kërkesa për QLI si informacion kthyes për atë se çfarë informacionesh dëshirojnë të shohin qytetarët, dhe si pasojë t'i publikojnë dhe azhurojnë atë regullisht.
- Qeveria duhet të vazhdojë t'i nxis institucionet të publikojnë më shumë sete të dhënash.
- Njësitë e vetëqeverisjes lokale (sidhe institucionet që funksionojnë nën menaxhimin e tyre si shkollat e spitalet) duhet të trajnohen dhe nxiten që t'i hapin të dhënat në format të lexueshëm nga makina.
- Qeveria duhet t'i përfshijë studentët e Teknologjisë informatike (si një grup entuziast dhe i informuar për të dhënat e hapura) nga të gjitha universitetet në vend në punëtori për të dhënat e hapura. Ata gjithashtu janë partner i dobishëm për grupin punues të PQH për të dhëna të hapura.
- Masat e plan veprimit për PQH duhet të kenë për synim masa inovative që të kenë ndikim të ndjeshëm në prioritetet e PQH.

Për Komisionin për QLI:

- Komisioni për QLI duhet të vishet me fuqinë që të vendosur ndëshkime për institucionet (mbajtës të informacioneve) që nuk i përmbahen Ligjit për QLI. Ajo gjithashtu do mundeshte të jepte ndëshkime për institucionet që ende nuk ofrojnë informacione për kontakt të nëpunësve përgjegjës për menaxhimin e QLI dhe listën e informacioneve publike.
- Komisioni për QLI duhet t'i rimendojë aktivitetet e veta për ndërtim të kapaciteteve me mbajtësit e informacioneve që t'i bëj trajnimet më me ndikim.

PARTNER TË PROJEKTIT

